



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2024-23

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland, Kryegjykatës
Gjykatës Rumen Nenkov
Gjykatëse Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 18 prill 2024

Gjuha: Anglishte

Titulli i dosjes: Kërkesë Referuese e Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Shkeljen e të Drejtave të Tyre Themelore të Garantuara nga Nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Gjuhën e Punës dhe Procedurën e Mëtejshme

Parashtruesve

Sabit Januzi
Ismet Bahtijari
Haxhi Shala

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

1. Më 3 prill 2024, z. Sabit Januzi, z. Ismet Bahtijari dhe z. Haxhi Shala ("parashtruesit") i dorëzuan Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese kërkesë referuese të datës 3 prill 2024 ("Kërkesa Referuese"),¹ bazuar në nenet 30 dhe 31 Kushtetutës së Kosovës ("Kushtetuta"), nenin 49(2) e (3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 4(b) e (c), 21 dhe 29 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"). Përfaqësuesit e parashtruesve janë: z. Xhonatan Elistan Ris dhe z. Hju Bauden për z. Januzi, znj. Felisiti Geri dhe z. Xhejms O'Kif për z. Bahtijari, si dhe z. Tobi Kadman dhe z. Xhon Kabën për z. Shala.
2. Më 5 prill 2024, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në pajtim me nenin 33(3) të Ligjit, caktoi Panelin e mësipërm për të vendosur në lidhje me Kërkesën Referuese.²
3. Sipas nenit 20 të Ligjit dhe rregullës 5 të Rregullores, Paneli vendos gjuhët e punës për procedurat para tij. Meqenëse parashtruesit e kanë bërë Kërkesën Referuese në anglishte, gjuha e punës e kësaj procedure do të jetë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, të mundësuar nga Zyra Administrative.
4. Gjithashtu, Paneli nuk e gjykon të nevojshme në këtë fazë të kërkojë informacion apo parashtrime shtesë sipas rregullës 15(2) të Rregullores.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA,

Paneli i Gjykatës Kushtetuese

Vendos që gjuha e punës e kësaj procedure të jetë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara –

¹ F00001, Kërkesë Referuese e 1) Sabit Januzit, 2) Ismet Bahtijarit dhe 3) Haxhi Shalës drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Vlefshmërinë Kushtetuese të KSC-BD-25/Rev1 (Rregullorja e Ndihmës Juridike e Rishikuar), 3 prill 2024.

² F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, 5 prill 2024.

përkatësisht në shqipe, serbishte dhe anglishte – të mundësuar nga Zyra Administrative.

/nënshkrimi/

Vidar Stensland
Kryegjykatës

Përpiluar në anglishte, e enjte, 18 prill 2024
Në Hagë, Holandë